



Quality Endurance Passion

## Gulf ATF DX II

# LËNG PËR KAMBIO AUTOMATIKE



### Gulf ATF DX II

**Gulf ATF DX II** është një lubrifikant transmisionesh automatike për automjetet e vjetra të cilat përdorin lubrifikantë të cilësisë DEXRON®-II D. Cilësia e lartë e bazës së vajrave dhe sistemit të veçantë shtesë të përdorura në këtë lubrifikant, ofrojnë rezistencë ndaj oksidimit, veti më të mira ndaj fërkimit, rrjedhshmëri të mirë në temperatura të ulta, përputhshmëri të guarnicionit dhe mbrojtje ndaj veshjes. Gulf ATF DX II tejkalon kërkesat më të larta të performancës nga General Motors DEXRON®-II D dhe ofron përvojë të shkëlqyer të drejtimit të automjetit në një shumëllojshmëri kushtesh.

**Gulf ATF DX II** ka stabilitet të mirë termoksidues që minimizon formimin e llakut, mbetjeve dhe depozitimeve duke mbajtur kutinë e transmisionit të pastër. Karakteristikat e kontrollit të fërkimit ndihmojnë në ndërrime të qëndrueshme dhe të qeta të vajit nën ndikimin e një shumëllojshmëri kushtesh gjatë drejtimit të automjetit; ndërsa përmirësimi i teknologjisë kundër veshjes mbron pjesët kritike të transmisionit. Indeksi jashtëzakonisht i lartë i viskozitetit siguron lubrifikim të përshtatshëm si në temperaturë të lartë dhe në temperature të ulët gjatë ndezjes, ndërsa kontrolli i mirë i shkumës çon në mirëkontrollin dhe lehtësimin e ndërrimit duke zvogëluar humbjen e vajit. Rrjedhshmëria në temperatura të ulta ndihmon në ndezjen në temperatura të ulta dhe siguron mbrojtje më të mirë kundër ndryshkjes dhe korrozionit. Gulf ATF DX II është në përputhje me të gjitha materialet e guarnicionit.

**Gulf ATF DX II** rekomandohet për të gjitha automjetet e General Motors që kërkojnë cilësinë DEXRON®-II D. Gjithashtu rekomandohet për autoveturat, disa nga transmetimet manuale dhe hidraulike ku lloje të tillë lubrifikantësh janë të nevojshëm.



Quality Endurance Passion

## Gulf ATF DX II

### SPECIFIKIMET



*Plotëson specifikimet e: General Motors  
DEXRON® IID*

*Aprovuar nga: ZF TE-ML 02F/04D*

Karakteristika	Metodat e testit:	Vlerat tipike:
Densiteti @ 15°C	ASTM D4052	863 kg/m <sup>3</sup>
Viskoziteti Kinematik @ 40°C	ASTM D445	37.3 mm <sup>2</sup> /s (cSt)
Viskoziteti Kinematik @ 100°C	ASTM D445	7.0 mm <sup>2</sup> /s (cSt)
Viskoziteti Brookfield@ -40 ° C	ASTM D5293	<50000 mPa.s (cP)
Indeksi i Viskozitetit	ASTM D2270	>140
Pika e Ndezjes	ASTM D92	>140°C
Pika e Derdhjes	ASTM D97	<-42°C
Ngjyra	E Dukshme	E kuqe
Kodi i Produktit: 2502	Data e lëshimit: 22/06/2012	Data e zëvendësimit: 30/11/2011
		Rishikimi nr: 03